

VENDIM
Nr.757, datë 1.11.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR
REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT TË QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË
KULTURËS “ARBNO RI” DHE KTHIMIN E SAJ NË TEATËR KOMBËTAR DHE
GALERI KOMBËTARE TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Studim-projektim”, artikulli 230, t’i shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, për realizimin, me tender të hapur ndërkombëtar, të studim-projektimit të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Arbnori” dhe kthimin e saj në Teatër Kombëtar dhe Galeri Kombëtare të Arteve.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha